



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05 - 306

Podujevë,
22/07/2020

Bazuar në nenin 20 pika 1, të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, i datës 29/08/2011, neni 5, pika d e Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, të datës 21/05/2008 dhe Udhëzimit Administrativ i MASHT-it për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, nr. 15/2019, të datës 19/07/2019, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Podujevës, shpall:

KONKURS

Për drejtorë dhe zëvendës drejtorë në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të lartë

Drejtor në gjimnazin "Aleksandër Xhuvani" Podujevë;
Zëvendës drejtor në gjimnazin "Aleksandër Xhuvani" Podujevë;
Drejtor në SHMLT "Fan S. Noli" Podujevë;
Zëvendës drejtor në SHMLT "Fan S. Noli" Podujevë;
Drejtor në SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" Podujevë;
Zëvendës drejtor në SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" Podujevë;
Drejtor në SHFMU "Shaban Shala" Podujevë;
Drejtor në SHFMU "Naim Frashëri" Podujevë;
Drejtor në SHFMU "Xheladin Rekalii" Podujevë;
Drejtor në SHFMU "Luigj Gurakuqi" Batllavë;
Drejtor në SHFMU "Sami Frashëri" Zhiti;
Drejtor në SHFMU "Jetullah Gashi" Dobërdol;
Drejtor në SHFMU "Lasgush Poradeci" Dumnicë e Poshtme;
Drejtor në SHFMU "Hyzriu e Samiu" Letanc;
Drejtor në SHFMU "Kongresi i Manastirit" Gllamnik;
Drejtor në SHFMU "Nuhi Gashi" Bradash;
Drejtor në SHFMU "Kadri Kadriu" Llaushë;
Drejtor në SHFMU "Elfir Behrami" Metehi;
Drejtor në SHFMU "Jetullah Islami" Dyz;
Drejtor në SHFMU "Ilir Konushefci" Llugë;
Drejtor në SHFMU "Eqrem Çabej" Buricë;
Drejtor në SHFMU "Hasan Ramadani" Shajkofc;
Drejtor në SHFMU "Dituria" Llapashticë e Poshtme;
Drejtor në SHFMU "Shefki Latifi" Pollatë;

Drejtor në SHFMU "Sheqë Mirofci" Shtedim;
Drejtor në SHFMU "Jahë Hasani" Bërvenik;
Drejtor në SHFMU "Shefki Kuleta" Tërnavë;
Drejtor në SHFMU "Ali Ajeti" Sfeçël;
Drejtor në SHFMU "Ali Hadri" Obranqë;
Drejtor në SHFMU "Naum Veqilharxhi" Llapashticë e Epërme;
Drejtor në SHFMU "Zahir Pajaziti" Orllan;
Drejtor në SHFMU "Musli Dumoshi" Dumosh;
Drejtor në SHFMU "Rilindja" Horticë;
Drejtor në SHFMU "Afrimi e Fahriu" Lluzhan;
Drejtor në SHFMU "Zenel Hajdini" Lupç i Poshtëm;
Drejtor në SHFMU "Pavarësia" Siboc;
Drejtor në Çerdhen për fëmijë "Armela" Podujevë;

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

1. Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendet e punës drejtor dhe zëvendësdrejtor duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit:
 - Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimi 330 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
 - Master arsimor (kualifikimi prej 300 ECTS, 5 vite të shkollimit universitar);
 - Fakulteti katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, 4 vite të shkollimit universitar);
 - Bachelor katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, 4 vite të shkollimit universitar).
2. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
3. Të kenë të përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të aprovuar nga MASHT, sipas rekomandimeve nga KSHLM;
4. Të kenë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor:
 - Pesë (5) vite përvojë punë në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për nivelin e arsimit të mesëm të lartë;
 - Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatë për nivele tjera dhe
 - Tre (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatë për zëvendësdrejtor;
5. Të posedojnë këto dokumente:
 - 5.1. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës:
 - Në arsimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (gjimnaze) duhet të jetë profili arsimor në bazë të normativit profesional për arsimin e përgjithshëm;

- Për shkollat profesionale, kandidati/ja duhet të jetë i profilit përkatës për institucionin edukativo-arsimo ku konkurren, në bazë të normativit për arsimin profesional.
- 5.2. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- 5.3. Dëshminë se nuk është nën hetime dhe nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- 5.4. Dëshmi për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
- 5.5. Konceptin e Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor për të cilin konkurren. Koncepti duhet të bazohet në fushat e cilësisë në arsim dhe të ketë 5-10 faqe tekst (teksti me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12 arial);
- 5.6. Letër referencë me përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimin paraprak nga një institucion publik – kredibil (si MASHT, DKA, Këshilli drejtues i institucionit edukativo-arsimor, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të larët dhe individ me të cilët ka punuar ngushtë në programe të ndryshme për arsim);
- 5.7. Letër motivuese për vendin e punës për të cilin aplikon;
- 5.8. Portfolion profesionale (shih shtojcën G të Udhëzimit administrativ të MASHT-it, për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, nr. 15/2019, të datës 19/07/2019);
- 5.9. Kandidati/ja për drejtor dhe zëvendës drejtor nuk mund të jetë në funksion udhëheqës politik gjatë tri viteve para aplikimit;
- 5.10. Certifikatën e lindjes;

Detyrat e punës:

Drejtori i institucionit edukativo-arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit.

Kohëzgjatja:

Periudha kohore e kontratës zgjatë 4 (katër) vjet.

Afati i konkursit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës, në mediat e shkruara dhe në ueb faqen e komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (23/07/2020-06/08/2020).

Dokumentet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë në objektin e komunës, rr. "Nuhi Gashi", Podujevë.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk shqyrtohen.

Secili konkurren dorëzon kopjen e vërtetuar të diplomës – dokumentet e shkollimit.

Për të gjitha vendet e punës mbahen intervista, kurse orari i intervistimit shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të objektit të komunës.

Agim Blakçori
Drejtor i DKA-së

